

**20261582287**

Në bazë të nenit 110 të Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23, 193/24, 75/25, 154/25, 269/25 dhe 62/26), Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, miratoi

**RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES SË PËRCAKTIMIT TË  
VENDEVE TË PUNËS, NË TË CILAT, STAZHI I SIGURIMIT LLOGARITET ME  
KOHËZGJATJE TË SHTUAR**

**Neni 1**

Në Rregulloren e Përcaktimit të Vendeve të Punës, në të cilat, stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të shtuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 174/25 dhe 74/26), në nenin 1, pas pjesës “HIDROCENTRALET”, shtohet nënndarje e re „Hidrocentralet mbitokësore“, me tri vende pune, si në vijim:

Hidrocentralet mbitokësore

|                                          |       |
|------------------------------------------|-------|
| Operator kryesor (Kryeoperator)          | 12/14 |
| Operator (me arsim profesional elektrik) | 12/14 |
| Operator (me arsim profesional mekanik)  | 12/14 |

**Neni 2**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 09-4960/1  
13.7.2026  
Shkup

Ministri i Politikës Sociale,  
Demografisë dhe të Rinjve,  
**Fatmir Limani, d.v.**